



Muhamedi sipas këndvështrimit të krishterë

Description

Keith Ward

Në këtë ese dëshiroj të tregoj se ndonëse shumë vlerësime tradicionale të krishtera për figurën e Muhamedit kanë qenë negative, gjithsesi duke nisur nga shekulli i nëntëmbëdhjetë janë bërë shumë përpjekje domethënëse për ta parë figurën e tij në një këndvështrim më pozitiv. Unë do të shqyrtoj veprën e peshkopit Kenneth Cragg si një shembull prijatar i përpjekjeve të tilla. Ai tregoi se si të krishterët mund ta shihnin figurën e Muhamedit si atë të një profeti të vërtetë, të një njeriu të frymëzuar nga Zoti, dhe se si të krishterët mund ta shohin Kuranin si një shpallje hyjnore, ndonëse duke mos pranuar pagabueshmërinë e tij. Cragg-u skicoi një dallim të theksuar midis Jezusit të parë si shprehja e dashurisë së pakushtëzuar dhe Muhamedit të parë si burrë shteti dhe një luftëtar i shqetësuar për drejtësinë sociale. Në vijim do të sugjeroj se ky kontrast nuk është absolut, dhe se jetët dhe mësimet e Jezusit dhe Muhamedit mund të shihen si revelata plotësuese të vullnetit hyjnor. Ndonëse kjo nuk do të zgjidh disa dallime thelbësore midis Islamit dhe Krishterimit, përsëri është e rëndësishme për të krishterët që të vlerësojnë idealin e devocionit të plotë ndaj Zotit që Muhamedi simbolizon për myslimanët.

Vlerësimet negative të krishtera për Muhamedin

Me keqardhje më duhet të them se historia e vlerësimeve të krishtera për Muhamedin ka qenë një historie e shpifjeve dhe e shtrembërimeve. Arsyet për një qasje të tillë nuk janë të vështira për tu gjetur. Kurani i ndalon myslimanët të flasin për një “Bir të Zotit”, apo të thonë se

“Zoti është njëri prej të treve”. Dukeqenëse këto tema janë qendrorë për besimin e krishterë, shumë të krishterëve i është dukur se revelata e Muhamedit duhet të ketë qenë e gënjeshtërt, dhe se Muhamedi duhet të ketë qenë i mashtruar, për të mos thënë qëllimisht kundërshtues ndaj besimit të krishterë.

Për rrjedhojë, nuk janë bërë orvatje të shumta për të formuluar një vlerësim pozitiv të profetit Muhamed, i cili të ishte në gjendje të kapte diçka nga nderimi që myslimanët kanë për të, apo nga ideali i jetës njerëzore që ai përfaqëson për ata. Qasja e përgjithshme ka qenë ajo e paraqitjes së tij si një heretik, me një kuptim të gënjeshtërt dhe të papërshtatshëm për Zotin. Në kohët mesjetare, ai është emërtuar nga disa të krishterë si ‘Maohund’, djalli ose shpirti i errësirës. Pasja e një numri të caktuar grash nga ana e tij përshkruhej si shturje seksuale (ndonëse mbreti Salomon kishte pasur njëmijë gra dhe i kishte shpëtuar çdo kritike nga ana e të krishterëve). Zgjuarsia e tij e suksesshme ushtarake përshkruhej si agresivitet luftëdashës (ndonëse kryqëzatat e krishtera duartrokiteshin ndërsa masakroheshin të krishterët ortodoks të lindjes në Konstandinopojë). Po ashtu edhe përshkrimet e tij mjaft poetike të parajsës përshkruheshin si premtime për një orgji seksuale të pafund me virgjëresha të reja (ndonëse fjala seks nuk është përmendur asnjëherë në pasazhet kuranore të cilat flasin për bashkimin me hyriet e bukura të parajsës).

Për ta zbutur, duhet të themi se rrëfime, të cilët në ditët tona, mund të duken të ekzagjeruara apo të pahijshme përhapeshin nga vetë myslimanët, të cilët ishin të etur për të theksuar superioritetin e Muhamedit si luftëtar dhe hero seksual, si dhe për të zhvilluar një përfytyrim tepër materialist të parajsës. Në këto veprime, ata ndoshta ishin më shumë të shqetësuar për të legjitimuar varësinë e tyre ndaj zhvatjeve ushtarake dhe seksuale, si dhe orientimin e tyre tepër materialist. Sidoqoftë, ata e përshkruanin profetin në një mënyrë të cilën e shihnin si pozitive, por e cila perceptohej nga të krishterët (të cilët e ndjenin veten të kërcënuar nga suksesi ushtarak i myslimanëve) si moralisht i dyshimtë. Ky fakt siguroi municione të shumta për kritikët e krishterë, por unë mendoj se jemi të autorizuar të themi se Islami, ngjashëm edhe Krishterimi, ndonjëherë ka nevojë të mbrohet nga vetë mbrojtësit e tij të mëparshëm. Padyshim që të krishterët kanë qenë më shumë se të gatshëm për të parë një anë negative të Muhamedit. Ata i zhvilluan dhe i ekzagjeruan ato aspekte të traditave rreth Muhamedit të cilat theksonin superioritetin ushtarak dhe dominimin patriarkal të tij. Përkatësisht, ata minimizuan dhe anashkaluan elementet e tjera po aq të fuqishme të traditave të cilat bënë fjalë për tolerancën e Muhamedit, prirjet e tij demokratike dhe johierarkike si dhe besnikërinë e tij të papërkulur ndaj monoteizmit.

Si rrjedhojë në prej poetëve më të mëdhenj të krishterë, Dante Aligieri, e vendosi Muhamedin në ferr, i shqyer në copa nga derrat. Martin Luteri e shihte Muhamedin dhe papën si armiqtë kryesorë të Krishtit. Volteri, në vitin 1742, shkroi një sulm sarkastik mbi profetin në dramën e tij të titulluar “Muhamed”. Është tepër e turpshme për të vazhduar me ngjarjet të tilla të cilat synonin të demonizonin Muhamedin. Ato kanë ekzistuar, e të krishterët duhet të pendohen dhe të kërkojnë falje për idiotësinë dhe keqdashësinë e tyre.

Këndvështrimet e krishtera të cilat e shohin Muhamedin si një profet

Duhet përmendur se kanë ekzistuar gjithnjë përpjekje për të arrirë në një vlerësim më pozitiv dhe dashamirës ndaj profetit Muhamed. Ndërmjet britanikëve, poeti Carlyle ishte një prej të parëve i cili, në

një leksion mbi heronjtë dhe profetët të mbajtur në vitin 1840, u përpoq ta shihte Muhamedin si një hero të mirëfilltë ndërmjet profetëve[1]. Veçanërisht në shekullin e fundit, shkrimtarët e krishterë janë përpjekur të jenë të drejtë me figurën e Muhamedit, i cili ia kushtoi jetën e tij bindjes ndaj Zotit, si dhe të pranojnë vokacionin e tij të vështirë si një profet. Janë shkruar shumë libra nga të krishterë të cilët janë përpjekur të japin një portretizim më dashamirës të Muhamedit, ndonëse është pothuajse e pamundur për një të krishterë që ta shohë Muhamedin njësoj siç bëjnë edhe myslimanët, kjo për arsye të cilat unë do përpiqem ti qartësoj në vijim. Gjithsesi, një vlerësim i ndjeshëm dhe pozitiv është i mundur të arrihet, dhe ndërmjet shkrimtarëve bashkëkohorë të krishterë Kenneth Cragg është ndoshta ai i cili i ka kushtuar kësaj çështjeje rëndësinë më të madhe.

Cragg ishte një peshkopi anglikan i Jeruzalemit, dhe komentuesi më i mirë i krishterë përsa i përket Islamit, ai zotëronte një dije të mrekullueshme rreth subjektit të tij dhe një dëshirë të vërtetë për të shtyrë përpara kuptimin dhe miqësinë midis Islamit dhe Krishterimit. Në një sërë librash, por veçanërisht në librin e tij *“Muhamedi dhe të krishterët”* [2], i shkruar kryesisht për të krishterët, ai ka folur në një mënyrë të tillë që padyshim ka përforcuar pafund kuptimin dhe admirimin e krishterë për Islamin.

Që në fillim, ai e pranonte Muhamedin si një profet të vërtetë të unitetit, sovranitetit, kërkesës dhe gjykimit të Zotit. Ai e njihte atë si një njeri i cili jetoi në bindje të plotë e të ndërgjegjshme ndaj Zotit, në këtë ai ishte një njeri i cili kishte realizuar idealin e jetës myslimane duke qenë “i pari prej myslimanëve”, i pari në nder dhe rëndësi prej robërve të Zotit. Vështirësia e parë madhore që shfaqet për të krishterët është se Kurani shpesh duket se kundërshton Dhjatën e Re, e cila është shkrimi bazë i besimit të krishterë. Më qartësisht ky kundërshtim shfaqet në mohimin që Kurani i bën kryqëzimit të Jezusit, i cili qëndron në zemër të devocionit të krishterë. Për rrjedhojë, është e pamundur për të krishterët që të pranojnë idenë e pagabueshmërisë së Kuranit, e në lidhje me këtë ata e kanë të pamundur ta vlerësojnë Muhamedin si një mjet i fjalës së Zotit. Sidoqoftë, pohon Cragg-u, është e mundur ta pranojmë diçka si shpallje madje edhe atëherë kur ajo është e gabueshme, shumë të krishterë kanë këtë mendim edhe për tekstin biblik. Por pak, për të mos thënë asnjë, myslimanë janë të gatshëm të pranojnë këtë këndvështrim.

Këtu përballemi me një çështje thelbësore lidhur me natyrën e revelatës hyjnore. Të krishterët zakonisht kanë pohuar se Bibla është e frymëzuar nga Zoti, e shpesh ata kanë menduar se ajo është pagabueshme. Por është e qartë se Bibla është shkruar nga shumë njerëz të ndryshëm përgjatë periudhave të ndryshme historike, dhe se ajo përmban shumë këndvështrime të ndryshme, duke nisur që nga pesimizmi i librit të Predikuesit deri tek optimizmi i disa psalmeve të caktuara. Kështu që ideja e frymëzimit ka qenë gjithnjë një çështje e ndërlikuar në teologjinë e krishterë, dhe rrallëherë është folur për ndonjë diktim të fjalës së vërtetë të Zotit, në kuptimin që Zoti ishte autori i drejtpërdrejt i saj (Biblës). Për rrjedhojë, për të krishterët është krejtësisht e mundur ta interpretojnë idenë e frymëzimit në një kuptim të gjerë, i cili nuk përmban doemos idenë e pagabueshmërisë, veçanërisht në lidhje me çështje të errëta apo ndryshe me fakte të panjohura.

Një rrugë e tillë nuk është e disponueshme për myslimanët, për të cilët Muhamedi ishte thjeshtëpërçuesi i Kuranit, të cilin ai e recitonte ashtu siç e dëgjonte nga engjëlli Xhebrail. Kuptimi i verseteve kuranore mund të jetë krejtësisht i paqartë dhe i parrokshëm nga ndonjë interpretim, por gjithsesi atombeten ende versete të shpallura drejtpërdrejt nga Zoti dhe nuk janë subjekt i asnjë rishikimi tëmundshëm. Kështu që do të ketë gjithnjë një dallim midis të krishterëve dhe myslimanëve në lidhje me llojin e profetit që Muhamedi përfaqësonte.

Të krishterët mund ta shohin atë si një njeri të frymëzuar vërtet prej Zotit, i thirrur nga Ai për të shpallur një besim rreptësisht monoteist, dhe të zgjedhur prej Tij për këtë qëllim. Duke e parë figurën e Muhamedit në këtë këndvështrim, të krishterët mund ta rreshtojnë atë në të njëjtin nivel me të gjithë profetët e Izraelit dhe me apostujt e hershëm të kishës së krishterë. Madje, nga një këndvështrim vërtet i krishterë, do të ishte e mundur që Muhamedin ta vendosnim në të njëjtin nivel me Jezu Krishtin, përse i përket profetësisë (duke mos anashkaluar faktin që për të krishterët Jezu Krishti është më shumë se “thjesht një profet” [3]). Me fjalë të tjera, një i krishterë mund ta shohë Muhamedin si një njeri të frymëzuar në të njëjtin kuptim si profetët hebrenj dhe të krishterë, rrjedhimisht ti njohë atij nderimin më të lartë që i takon një profeti të vërtetë. Sidoqoftë, megjithëkëtë që sapo thamë të krishterët përsëri nuk barazohen me perceptimin mysliman që e sheh Muhamedin si të zgjedhurin unik të Zotit për të shprehur fjalën përfundimtare dhe të padiskutueshme të Tij. Të krishterët nuk janë të njëzëshëm as midis tyre përse i përket natyrës së saktë të revelatës, rreth asaj se deri në çfarë pike ajo duhet marrë në mënyrë të fjalëpërfjalshme. Por pranohet gjerësisht së fokusi i revelatës është personi i Jezu Krishtit, dhe se pikërisht në personin e tij shquhet imazhi i dukshëm i Zotit të padukshëm. [4] Zakonisht myslimanët nuk shohin në këtë mënyrë as Jezusin e as Muhamedin. Për Islamin njerëzit nuk janë të krijuar sipas imazhit të Zotit dhe Muhamedi, ndonëse zakonisht është parë si një qenie e përsosur njerëzore, nuk shihet si një imazh apo shprehje e hyjnore, e cila mbetet krejtësisht e ndryshme nga gjithçka. Muhamedi është profeti i përsosur, ai i cili i është nënshtruar plotësisht dhe realisht Zotit, por jo dikush i cili tregon se çfarë është Zoti (disa grupe myslimane si Ismailitët e kanë parë Muhamedin në këtë këndvështrim, por ata janë konsideruar gjithnjë si heretikë).

Kështu që perceptimi i të krishterëve për Muhamedin si një profet, asnjëherë nuk mund të pajtohet me perceptimin mysliman për të. Për të krishterët, Muhamedi mund të shihet si një njeri i frymëzuar nga Zoti, i pajisur me një mesazh hyjnor të vërtetë i cili, gjithsesi, është i kufizuar në varësi të vendit dhe kohës. Për myslimanët, Muhamedi ishte krejtësisht i pastër, por gjithnjë plotësisht dhe thjesht një njeri, mjet për përçimin e fjalës së vërtetë të Zotit, e cila nuk gënjen dhe nuk shtiret asnjëherë. Për të krishterët, është e krejtësisht e mundur që ti japin Muhamedit nderimin më të madh si një profet, e të shohin tek ai një ideal të veçantë njerëzor. Por mbetja e dallimeve në perceptim vjen si pasojë e dallimeve në kuptimin e thelbit të revelatës, dhe të mënyrës se si ajo jepet dhe pranohet. Nëse arrijmë ta kuptojmë plotësisht këtë pikë atëherë do të kemi më pak tundime për të denigruar si Jezusin ashtu edhe Muhamedin. Është e mundur që ti shohim këto personazhe si trupëzime të llojeve të ndryshme të revelatës, ose më së paku si përmbledhës të kuptimeve të ndryshme të revelatës hyjnore. Në këtë mënyrë ata do të mbeteshin krejtësisht vetvetja, e jo lloje të ndryshme të të njëjtës gjë. Nga kjo mund të kuptohet se si gjithsecili prej tyre u bë burimi krijues i revelatës hyjnore, ndonëse të llojit të ndryshëm, për bashkësitë të cilat jetojnë falë mësimëve të tyre.

Jezusi dhe Muhamedi

Dallimet themelore, ndërmjet Islamit dhe Krishterimit, në kuptimin e revelatës kanë dërguar në një tjetër grup mospajtimesh në lidhje me rolin e njeriut në revelatë. Muhamedi ishte një luftëtarë dhe burrë shteti i suksesshëm, mësimet e të cilit dërguan në unitetin e shumë fiseve arabe dhe në kohezionin e tyre në një fuqi morale dhe ushtarake të jashtëzakonshme. Ndërsa Jezusi, siç pohojnë të krishterët, vdiq si një kriminel ndërsa dishepujt e tij mbetën për shumë vite si një minoritet i shtypur dhe i marginalizuar, pa asnjë rol politik domethënës. Shpesh myslimanët nuk arrin të shohin asnjë vlerë në qasjen tepër pasive të Jezusit përballë shtypjes së ushtruar ndaj tij. Ngjashëm, të krishterët ndonjëherë e shohin vendosmërinë e Muhamedit në përdorimin e forcës, për të dërrmuar kundërshtarët e tij, më shumë si një dobësi se sa një virtut. Kjo, madje edhe sipas Cragg-ut, dërgon në krijimin e një dallimi të theksuar midis dashurisë së pakushtëzuar të Jezusit dhe bashkimit përmes përpjekjes së armatosur që Muhamedi i urdhëroi ndjekësve të tij.

Cragg-u me të drejtë e konsideroi kryqëzimin si pjesa më qendrore e revelatës së krishterë. Për të, ai tregon, më shumë se gjithçka tjetër, gjerësinë dhe thellësinë e dashurisë së pakushtëzuar e cila është përgatitur për të vuajtur maksimalisht në mënyrë që të bëjë të mundur pajtimin e njerëzimit me Zotin. Ndërsa Kurani mohon që Jezusi të jetë kryqëzuar. Sipas tij Jezusi është ngritur drejtpërsëdrejti në praninë e Zotit, misioni i tij dështoi, dhe hebrenjve thjesht i ngjau sikur e kryqëzuan atë. Një prej arsyeve për një mohim të tillë mund jetë edhe se një mysliman nuk arrin ta kuptojë se si një shërbëtor i Zotit mund të vuajë disfatën. Mohimi i kryqëzimit të Jezusit është shenjë për atë që, sipas të krishterëve, mesa duket është një lloj mangësie apo boshllëku në shpalljen e mesazhit hyjnor të përçuar nga Muhamedi. Siç është shprehur edhe Cragg-u, "Për të krishterët modeli i jetës (*sirës*) së Muhamedit do të jetë gjithnjë në konflikt me fuqinë dhe perspektivën e kryqit" [5] Muhamedi ishte qartësisht një luftëtarë dhe një lider politik. Pjesa më e madhe e tërheqjes që myslimanët kanë ndaj tij qëndron në faktin se ai shihet prej tyre si një profet ideal, mësues, bashkëshort, lider, udhëheqës, administrator dhe njeri. Ai nuk mund të ketë qenë ideal nëse nuk do të ishte përfshirë plotësisht në jetën ekonomike dhe sociale të njerëzve të tij. Një jetë e cila përfshin një lloj arratisje nga përgjegjësia dhe përfshirja sociale do të shihet si e mangët ose e papërsosur. Njeriu ideal duhet të ketë qenë i martuar dhe një lider i suksesshëm, në kuptimin politik të fjalës. Kur të krishterët e marrin Jezusin si idealin e tyre, ata kuptojnë krejt tjetër gjë. Jezusi pothuajse sigurisht ka qenë i pamartuar, ai nuk ka qenë një figurë e suksesshme politike, dhe është paraqitur si një njeri që ka rekomanduar paqen dhe si një njeri që ka pranuar një vdekje të padrejtë pa u përpjekur të ndreq shtypjen që i bëhej popullit hebre në atë kohë. Rrjedhimisht, të krishterët e shohin dashurinë vuajtëse si një element thelbësor në vetshpalljen hyjnore, dhe janë shumë të kujdesshëm në konsiderimin e dhunës së çfarëdolloji si një pjesë e mesazhit hyjnor. Megjithatë ky kontrast është mbitheksuar shpesh si nga myslimanët ashtu edhe nga të krishterët. Pacifizmi ka qenë gjithnjë këndvështrimi minoritar midis të krishterëve, dhe doktrina e luftës së drejtë mund të jetë praktikisht e njëjtë me interpretimin mysliman për xhihadin. Ndër të krishterët gjenden shumë asket, priftërinj e murgësia, por sidoqoftë ato kanë qenë gjithnjë një minoritet, ndonëse ato kanë një vokacion të veçantë i cili nuk është pjesë e dishepullizmit normal të krishterë. Të krishterët nuk e shohin Jezusin si një figurë krejtësisht askete e ngjashme me përshkrimet e bëra për të në disa rrëfime myslimane. Në fund të fundit ai gjatë jetës së tij u konsiderua prej disave si "një grykës dhe një pijanec" [6]

Nga krahu mysliman Muhamedi rrallëherë, për të mos thënë asnjëherë, nuk është parë si ai i cili ishte përcaktuar për ta përhapur Islamin me shpatë, dhe si një njeri i cili kryesisht ishte i interesuar për të themeluar një perandori islame. Si një besimtar në Zotin e dhembshur dhe mëshirëplotë, ai i kishte përvetësuar edhe për veten e tij këto cilësi. Ai është parë, nga myslimanët, si një njeri i cili për hir të Zotit ishte i shqetësuar për eliminimin e padrejtësisë dhe shtypjes. Kjo ndonjëherë përfshinte edhe përdorimin e forcës, dhe padyshim që ai ishte i zotuar për të përdorur forcën si kundërpeshë ndaj padrejtësisë dhe për të mbrojtur myslimanët saherë që ato kërcënoheshin apo tradhtoheshin. Në këtë, ai ndiqte rrugën e profetëve dhe mbretërve të mëdhenj të Izraelit si Samsoni dhe Davidi, të cilët çliruan njerëzit e tyre nga shtypja duke përdorur në disa raste edhe forcën. Gjëja më e rëndësishme është që forca të përdoret me maturi dhe në mënyrë efektive, për të kërkuar drejtësinë dhe mëshirën, dhe jo për ti imponuar fenë dikujt tjetër. Cragg-u në një vend është shprehur: “çdo vlerësim i Muhamedit *in situ* duhet vendosmërisht të ruaj kuptimin mospajtues të dashurisë e cila vuajti në figurën e Krishtit...një kontrast që mbetet i qëndrueshëm dhe i pareduktueshëm.[7] Nuk jam i sigurt nëse fjala “mospajtim” është pikërisht ajo e goditura për këtë temë, megjithëkëtë padyshim që rreth kësaj çështjeje ka ekzistuar një mospajtim midis shumë bashkësive të veçanta islame dhe të krishtera. Ndoshta shprehja më e saktë do të ishte thënia se të krishterët theksojnë dashurinë vuajtëse si një vlerë të madhe, ndërsa myslimanët theksojnë aktualizimin e mëshirshëm të drejtësisë nën Zotin si veçorinë e tyre karakteristike. Megjithëkëtë këto dy këndvështrime nuk janë papajtueshme. Të krishterët duhet të kenë një ndjesi të përgjegjësisë shoqërore, ndërsa myslimanët duhet të praktikojnë durimin dhe këmbënguljen për hir të besnikërisë së tyre ndaj Zotit.

Vlerësim pozitiv i krishterë për Muhamedin

Cragg-u ka thënë: “Muhamedi është shfaqur...duke marrë shumë lehtë dhe duke praktikuar shumë lirisht miratimin e forcës” [8] Atë që ai dëshiron të thotë me këto fjalë është se gjenden vështirësi të mirënjohura, për myslimanët si dhe për të krishterët, rreth ndodhjeve të ndryshme në historinë e hershme islame, të tilla si masakra e Beni Kurejdhave, ku sipas haditheve raportohet se shtatëqind burrave të kapur robër iu pre koka me miratimin e profetit, ndërsa gratë dhe fëmijët e tyre u bënë skllëvër. Transmetime të tilla nuk janë marrë nga Kurani, dhe në Islam ato janë kundërshtuar dhe interpretuar në forma të ndryshme. Por mund të shihet vështirësia në faktin se gjykime të rrepta dhe të ashpra duket se kanë gëzuar miratimin e profetit. Në këtë situatë do të ishte e ndershme të tregonim se edhe Bibla regjistron ngjarje të ngjashme që në dukje janë miratuar nga Perëndia, dhe se Muhamedi më pas praktikoi një vetëpërmbytje dhe mëshirë shumë të madhe në sjelljen e tij ndaj armiqve të mundur. Mbeten ende shumë probleme të rënda dhe të ngutshme rreth asaj se çfarë duhet bërë me urdhrat kuranore për luftë të shenjtë dhe dënime të ashpra, por është po aq e vërtetë se ekzistojnë probleme rreth asaj se çfarë duhet bërë me urdhëresat e Dhjatës së Re për ti kthyer faqen tjetër dhe për të mos kundërshtuar të keqen. Si Islami ashtu edhe Krishterimi nuk kanë dhënë direktiva të qarta se si duhet të veprojnë, nën dritën e veprimeve personale të themeluesve të tyre, njerëzit edhe qeveritë e ditëve të sotme. Nevojitet një ndjeshmëri e lartë interpretuese në mënyrë që shembujt dhe normat e hershme të aplikohen në një botë e cila është shumë e ndryshme nga shkretëtira e fiseve nomade apo nga avanpostet e një diktature brutale ushtarake. Ngjarjet e së kaluarës ndoshta janë më

shumë direktiva për të tashmen se sa rregulla të pathyeshme për tu aplikuar paçka ndryshimit të rrethanave. Të krishterët e shohin thirrjen e Muhamedit për xhihad si shumë shqetësuese kur ajo përdoret si një thirrje shpotitëse nga grupe terroriste që e quajnë veten grupe islamike. Por kjo nuk do të thotë se në drejtimin e çështjeve njerëzore nuk ka vend për përdorimin e forcës. Dhe është shumë e pagjasë të mendosh për Muhamedin si një terrorist, apo si një njeri që nuk donte t'ia dinte për fatin e jetëve të njerëzve të pafajshëm.

Ndoshta në këtë pikë mund të themi se madje edhe përpjekja e sinqertë e ndërmarrë nga Cragg-u për të kuptuar, thjeshtëzon së tepërmi duke vënë në kontrast të thellë theksimin e krishterë mbi hirin dhe dashurinë, mëkatin dhe shpengimin, me theksimin e myslimanëve mbi xhihadin islam dhe pranimin e fuqisë politike. Siç është shprehur edhe ai vetë “të gjitha religjionet profetike janë domosdoshmërisht luftarake, të zotuar ndaj xhihadit”. Ajo që Jezusi i ka thënë një grupi të vogël e të pafuqishëm dishepujsh të cilët jetonin nën pushtimin ushtarak romak mund të jetë shumë e ndryshme nga ajo që një dishepull mund ta shohë si të drejtë për ta vepruar kur ai të jetë në një pozitë të favorshme fuqie politike. Dhe ajo që Muhamedi (ose Zoti përmes tij) i ka thënë një grupi anëtarësh fisesh me një mundësi të vërtetë për të marrë fuqinë dhe për ta bërë bashkësinë e tyre të dhunshme dhe të përçarë një shoqëri më të unifikuar dhe të drejtë, mund të jetë shumë e ndryshme nga ajo çka një udhëheqës i urtë dhe dashamirës i një shteti mysliman mund të bëjë ndaj minoriteteve paqësore jomyslimane brenda shtetit të tij.

Ndoshta në këtë pikë, ideja e plotësimit mund të jetë më e preferueshme se ajo e këmbënguljes në mospajtueshmërinë e dy vizioneve të lartpërmendura. Mund të jetë që sjellja njerëzore e luftëtarit dhe liderit politik i cili ishte profeti i Zotit mund të pasurohet përgjatë rrugës me vetsakrificën dhe dashurinë falëse të Jezusit i cili është përzgjedhur të jetë lideri i njerëzve të besëlidhjes së re. Dikush mund të shohë shenja të një përputhje të tillë në devocionin e sufinjve (por jo vetëm atyre) ndaj profetit, i cili e sheh profetin si një fokus të përshtatshëm devocioni, ndonëse gjithnjë duke reflektuar madhështinë e Zotit dhe duke aluduar përtej vetes së tij për pasjen e kësaj madhështie. Urtësia ideale e njeriut të punës ka pak gjasa të jetë krejtësisht e ndryshme në lloj nga urtësia e atij, fati i të cilit është të pranojë vdekjen në bindje ndaj vullnetit hyjnor në mënyrë që ti çlirojë njerëzit e tij nga kryelartësia dhe egoizmi. A nuk duhet ti shohim këto si dy forma të urtësisë së dhënë hyjnore?

Nuk dëshiroj të ngulmoj shumë në këtë pikë. Nuk më takon mua të them atë se çfarë myslimanët duhet të mendojnë për këtë gjë, ndonëse si i krishterë nuk do të hasja shumë vështirësi në njohjen e Muhamedit si mjet të revelatës hyjnore, si në mësimin e tij të sovranitetit dhe gjykimit hyjnor ashtu edhe në jetën e tij të nënshtrimit në bindje. Megjithëkëtë mospërputhjet janë ende ekzistuese. Jezusi ose është kryqëzuar, dhe ky është një fakt i rëndësishëm i fatit njerëzorë, ose jo. Muhamedi ose ka recituar revelatën përfundimtare të Zotit, duke përmbushur, ndrequr apo abroguar gjithçka që kishte ardhur para saj, ose jo. Na duhet të pranojmë që në këtë pikë ka një dallim të vërtetë dhe të pareduktueshëm, por gjithashtu mund të themi se dallime të tilla janë sinqerisht vlerësime të ndryshme të fakteve ashtu siç ato na shfaqen neve, dhe zgjidhja e tyre duhet lënë në dorë të Zotit, i cili është i vetmi që njeh të vërtetën e plotë. Këto dallime nuk nënkuptojnë se myslimanët kanë besim ndërsa të krishterët jo, dhe e anasjella. Këto dallime nuk nënkuptojnë se ose Muhamedi ose Jezusi duhen nënçmuar. Nderimi përkatës i duhet dhënë të dyve, ndonëse nuk duhet pritur që vlerësimi i saktë i secilit, apo madje se rrëfimi i jetës së secilit prej tyre i cili duket si më me gjasa, do të jetë i njëjtë.

Unë mendoj se vlerësimi bashkëkohorë i krishterë për Muhamedin, e nderon atë si një profet të vërtetë dhe njeri të urtë, një njeri të guximshëm dhe lider i dhembshur, një ideal për të gjithë ata të cilët

kërkojnë të udhëzojnë dhe udhëheqin një shoqëri. Besnikëria e të krishterëve ndaj dashurisë joegoiste të mishëruar tek Jezusi duhet të mbetet udhëzuesi themelor për jetesën e krishterë dhe të krishterët duhet ta nderojnë dhe adhurojnë Jezusin si ai i cili, sipas besimit të tyre, trupëzon imazhin e Zotit në formë njerëzore. Por ai mund të zgjerojë urtësinë e krishterë në mënyrë që të përfshi gjithashtu, të nderoj dhe të respektoj, edhe idealin e një profeti plotësisht të angazhuar shoqërisht i cili ia dedikoi çdo detaj të jetës së tij vullnetit hyjnor, dhe ftoi çdo burrë dhe grua për të pohuar se nuk ka Zot tjetër përveç Zotit dhe se askush nuk është i barabartë me Të. Një vlerësim i duhur i krishterë për figurën e Muhamedit mund të thellojë kuptimin që të krishterët kanë për besimin e tyre dhe, për sa kohë që njerëzit mund të pranojnë dallime të vërteta dhe të ndërgjegjshme në çështjet e besimit, nxit miqësinë dhe kuptimin midis të krishterëve dhe myslimanëve. Në botën moderne, kjo nuk është më thjesht një mundësi, por ajo është bërë falë caktimit hyjnor një domosdoshmëri.

[*] Keith Ward ka qenë Regius Professor of Divinity në Universitetin e Oksfordit, dhe një Canon of Christ Church në Oksford. Para kësaj, ai ka qenë profesor i historisë dhe filozofisë së religjionit në Universitetin e Londrës. Ai është një anëtar i akademisë angleze, dhe ndërmjet publikimeve të tij mund të spikasim një punim katërvëllimësh në teologjinë e krahasuar, të publikuar nën titullin: "Religion and Revelation, Religion and Creation, Religion and Human Nature and Religion and Community (Oxford: Oxford University Press, 1994-2000).

Përktheu: Rezart Beka

Referenca

[1] T. Carlyle, *On Heroes, Hero-Worship, and the Heroic in History* (ed. M.K. Goldberg; Berkley and Los Angeles, CA and Oxford: University of California Press, 1993), f. 37-66

[2] A.K. Cragg, *Muhammad and the Christian* (Oxford: Oneworld, 1999).

[3] Luka 7:26

[4] Krahaso: Kolosianëve 1:15

[5] A.K. Cragg, *Muhammad and the Christian*, f. 53

[6] Mateu 11:19

[7] A.K. Cragg, Muhammad and the Christian, f. 51

[8] A.K. Cragg, Muhammad and the Christian, f. 3

Date Created

11/10/2014

Author

erasmusi